



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	07-04	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity	
SKRIPSHUK	1664/2021		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.134/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.134/2021 të datës 12.03.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. "Car Llazari" pa nr.Graqanic, kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.134/2021 e datës 12.03.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën Radio komunikues në Stacionin Policor në Graqanic/Policia e Kosovës, më datë 12.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1101/2021 e regjistruar me numër A.nr.134/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës materiale për periudhën korrik ,gusht, shtator 2020 si dhe janar 2021, sipas pakos emergjente COVID-19.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.03.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankueses të Policia e Kosovës. Këshilli me datë 02.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroj këto prova: Ankesën e datës 12.03.2021 me numër protokolli 1101/2021 të regjistruar me numër A.nr.134/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.02/32 i datës 25.09.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Ankesa e datës 17.02.2021 e parashtruar në Komisionin për Ankesa në Policinë e Kosovës; E-mail zyrtar i datës 17.09.2020; Lista e angazhuar sipas Corona Virus; E-mail zyrtar i datës 16.09.2020; Lista e zyrtarëve të angazhuar sipas Corona virus; Lista e zyrtarëve të angazhuar për Corona virus për muajt korrik, gusht dhe shtator; lista e pagave e muajit mars 2021; E-mail i datës 28.12.2020; E-mail zyrtar i datës 01.11.2020; Lista e pagave i datës 05.03.2021; Kontrata e punës me nr.0498 e datës 02.11.2011; Përshkrim i detyrave të punës i datës 08.06.2015; E-mail zyrtar i datës 09.10.2020; E-mail zyrtar i datës 12.11.2020; E-mail zyrtar i datës 23.03.2021; E-mail zyrtar i datës 24.03.2021; Memorandum zyrtar i datës 03.08.2020; Memorandum zyrtar i datës 03.09.2020; Memorandum zyrtar i datës 03.10.2020; Vendimi me nr.02/32 i datës 25.09.20120 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kartela e nëpunësit; Kartela e nëpunësit e datës 23.03.2021; E-mail zyrtar i datës 16.02.2021 dhe Përgjigje në ankesë e datës 02.04.2021 nga organi i punësimit me numër protokolli 1599/2021 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 02.11.2011 të ankueses, ka konstatuar se ankuesja mban pozitën e punës "Radio komunikues" në Stacionin Policor në Graçanicë/Policia e Kosovës, dhe i njëjti sipas kontratës se punës kryen këto detyra të punës: *I pranon dhe i shpërndan informata hyrëse dhe dalëse nga zyra e komunikimit. Kujdeset për regjistrimin, sistemimin dhe shpërndarjen e informatave. Mban shënime dhe kujdeset për veprimet e patrullave. Pranon të gjitha thirrjet dhe i shpërndan informatat. Angazhimi për mbajtjen e komunikimit të nevojshëm me Departamentit/Drejtoritë dhe njësitë tjera të Policisë së Kosovës. Mban kontakt me institucionet e ndryshme brenda territorit që kujdeset stacioni apo njësia. Kujdeset për sigurimin e të dhënave të kërkuara për njësitë patrulluese në terren. Bënë verifikimin e personave të dyshuar në listat përkatëse. Bënë verifikimin e veturave (për regjistrim, vjedhje, aksident etj). Kryen edhe punë tjera që ja përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe e të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.*

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 6. **Nëpunës administrativo-technik dhe mbështetës** është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji ka konstatuar se pozita "radio komunikues" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-technik dhe mbështetës respektivisht ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.



Kolegji vlerëson se përderisa nuk kemi ndonjë akt administrativ nga organi kompetentë që ka vendosë në lidhje me deklarinimin e statusit të zyrtarëve publik të kësaj kategorie dhe mbi bazë të përshkrimit të detyrave të punës të njëjtit llogariten **Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës**.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.134/2021 e datës 12.03.2021 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtaret publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.134/2021, datë 07.04.2021**

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;





Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prilbato Received/Delivered	07. 04. 2021	1	viti god year
Organ /Rjeshtja Organ /Jedinita Org /Unit	In/Prat Pr/Prat Prat No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHIK	1664/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.br.134/2021

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova- Veçe za razmatranje i rešavanje žalbi u sastavu: Arben Mehmeti-predsednik, Ardita Haxhnikaj- Demi i Eshref Shabani-članovi i Sabile Avdyli- viša službenica za stručnu saradnju, u svojstvu zapisničarke, razmotrili su žalbu broj A.br.134/2021 od dana 12.03.2021.godine, podneta od žalioca Olgice Mitrović, sa prebivalištem u ul. "Car Lazar" bb Gračanica, protiv organa poslodavca/Policije Kosova, po pravnoj stvari "materijalna nadoknada", postupajući u skladu sa članom 6. stav 1 podstav 1.1. i članom 18 stav 1 podstav 1.8 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova i Pravilnika br.02/2018 o Proceduri razmatranja i rešavanja žalbi u Nezavisnom nadzorom odboru civilne službe, na raspravi za savetovanje i glasanje, održane dana 07.04.2021.godine, donosi ovu:

ODLUKU

I. Oglašava se nenadležnim Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, da odlučuje o žalbi broj A.br.134/2021 od dana 12.03.2021.godine podneta od žalioca Olgice Mitrović.

II. Odluka stupa na snagu na dan potpisivanja od predsednika Veća.

O b r a z l o ž e n j e

Žalioc Olgica Mitrović, zaposlena na radnom mestu – Dispečer u Policijskoj stanici u Gračanici/Policiji Kosova, dana 12.03.2021.godine, podnela je žalbu broj protokola 1101/2021, protokolisana pod brojem A.br.134/2021 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, navodeći žalbene tvrdnje o priznavanju prava na nadoknadu materijalnog dodatka za period jul, avgust, septembar 2020 godine kao i januar 2021.godine, prema hitnom paketu COVID-19.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, dana 16.03.2021.godine, uputio je zahtev radi davanja odgovora na žalbu žalioca u Policiji Kosova. Dana 02.04.2021.godine, Odbor je primio odgovor na žalbu zajedno sa spisima predmeta.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, utvrdilo je sledeće dokaze: Žalbu od dana 12.03.2021.godine broj protokola 1101/2021 i registrovana pod brojem A.br.134/2021 podneta u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova; Odluku br.02/32 od dana 25.09.2020.godine Vlade Republike Kosova; Žalbu od dana 17.02.2021.godine podneta Komisiji za žalbe u Policiji Kosova; Službeni e-mail od dana 17.09.2020.godine; Lista angažovana prema Corona Virus; Službeni e-mail od dana 16.09.2020.godine; Listu službenika angažovanih prema Corona virus; Službenu listu angažovanu za Corona virus za mesec jul, avgust i septembar; Platni spisak za mesec mart 2021; E-mail od dana 28.12.2020.godine; Službeni e-mail od dana 01.11.2020.godine; Platni spisak od dana 05.03.2021.godine; Ugovor o radu br.0498 od dana 02.11.2011.godine; Opis radnih zadataka od dana 08.06.2015; Službeni e-mail od dana 09.10.2020.godine; Službeni e-mail od dana 12.11.2020.godine; Službeni e-mail od dana 23.03.2021.godine; Službeni e-mail od dana 24.03.2021.godine; Službeni memorandum od dana 03.08.2020.godine; Službeni memorandum od dana 03.09.2020.godine; Službeni memorandum od dana 03.10.2020.godine; Odluku br.02/32 od dana 25.09.2020 Vlade Republike Kosova; Karticu službenika; Karticu službenika od dana 23.03.2021; Službeni e-mail od dana 16.02.2021.godine i Odgovor na žalbu od dana 02.04.2021.godine od organa poslodavca broj protokola 1599/2021 zajedno sa spisima predmeta.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, nakon razmatranja predmetnih spisa, utvrdilo je da Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, **nije nadležan** da odlučuje u vezi žalbe podneta od žalioca Oglice Mitrović, jer:

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi, na osnovu dokaza u predmetu, odnosno Ugovora o radu na neodređeno vreme od dana 02.11.2011.godine za žalioca, utvrdilo je da se žalioac nalazi na radnom mestu "Dispečer" u Policijskoj stanici u Gračanici / Policija Kosova, i ista prema ugovoru o radu obavlja sledeće radne zadatke: *Prima i distribuira dolazne i odlazne informacije iz kancelarije za komunikaciju. Brine o registraciji, sistematizaciji i raspodeli informacija. Vodi evidenciju i nadgleda akcije patrole. Prima sve pozive i distribuira informacije. Angažovanje za održavanje neophodne komunikacije sa Odeljenjem/Direkcijama i drugim jedinicama Kosovske policije. Održava kontakt sa raznim institucijama na teritoriji o kojoj se stara stanica ili jedinica. Brine se o obezbeđivanju potrebnih podataka za patrolne jedinice na terenu. Proverava sumnjiva lica na odgovarajućim spiskovima. Vršu proveru vozila (za registraciju, krađu, nesreću itd.). Obavlja druge poslove koje joj je dodelio neposredni nadzornik u skladu sa zakonima i podzakonskim aktima koji se opravdano mogu povremeno zahtevati i koji ne narušavaju dostojanstvo zaposlenog.*

Što se tiče prihvatljivosti žalbe, Veće je analiziralo odredbe Zakona br.06/L-114 o Javnim službenicima, odnosno člana 2. koji predviđa da: 3 **Civilni službenik** - je javni službenik u okviru Civilne službe koji vrši dužnost na jednoj poziciji, počev od profesionalnog službenika do pozicije generalnog sekretara u administraciji predsednika, u administraciji Skupštine, u Kancelariji premijera, ministarstvu, izvršnoj agenciji, i u jednoj od njenih lokalnih ogranaka, u administraciji institucija sistema pravosuđa, u nezavisnoj instituciji, nezavisnoj agenciji, opštinskoj upravi, kao i bilo koji zaposleni direktno definisan posebnim zakonom. 6. **Administrativno-tehnički službenik – osoblje podrške** je javni službenik, koji obavlja pomoćne delatnosti, održavanje, zaštitu, vožnju, kao i druge slične delatnosti u institucijama javne uprave i shodno tome na osnovu opisa posla podnosioca žalbe, Komisija je utvrdila da radno mesto „dispečer“ (radio operater) ulazi u kategoriju administrativno-tehničkih službenika i osoblja podrške, odnosno podnosilac žalbe nema status službenika u civilnoj službi.

Veće ocenjuje, da dok nemamo jedan upravni akt od nadležnog organa koji je odlučio u vezi deklarisanja statusa javnih službenika ove kategorije i na osnovu opisa radnih zadataka isti se računa **administrativno-tehnički službenik – i osoblje podrške**.

Dakle, na osnovu člana 6. stav 1 podstav 1.1 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, gde je utvrđeno da je Odbor nadležan za razmatranje samo žalbi civilnih službenika i kandidata za primanje u Civilnu službu i imajući u obzir konstataciju da žalioac ima status administrativno-tehničkog službenika i osoblje podrške, Veće konstatuje da Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, **nije nadležan** da odlučuje u vezi žalbe A.br.134/2021 od dana 12.03.2021.godine podneta od žalioaca Olgice Mitrović.

Veće za razmatranje žalbi, na osnovu člana 82 Zakona br.06/L-114 o Javnim službenicima, utvrdilo je da radni odnos administrativnog službenika i podrške, podleže zakonodavstvu o radu, i prema članu 24 stav 4 ovog zakona, javni službenici sa statusom administrativno-tehničkih službenika i osoblja podrške, imaju pravo da podnesu žalbu poslodavcu i nakon toga mogu pokrenuti upravni spor u nadležni sud.

Odluka stupa na snagu na dan potpisivanja od strane predsednika Veća.

Dakle, nakon analiziranja i ocene svih predmetnih spisa i zasnivajući se na član 18. stav 1 podstav 1.8 Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, Veće je odlučilo kao u dispozitivu ove odluke.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka koja tvrdi da je odluka Odbora nezakonita, može pokrenuti upravni spor u Osnovni sud u Prištini-Departman za Administrativna pitanja, u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke.

**Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova
Predmet broj A.br.134/2021, od dana 07.04.2021god.**

Sabile Avdyli

Zapisničarka

Arben MEHMETI

Predsednik Veća

Odluku dostaviti:

- Žaliocu Olgici Mitrović;
- Generalnom direktoru Policije Kosova;
- Kadrovskom rukovodiocu u Policiji Kosova i
- Arhivi NNOCSK-a.

Preveo:
Sh. Mujko

Dana, 07.04.2021.god.



